

TRASHËGIMIA KULTURORE DHE HISTORIKE E ANAMORAVËS-KONCEPTET E
MBROJTJES DHE MENAXHIMIT

TEMA PER TITULLIN
MASTER I HISTORISË

NGA

ALBAN SAHITI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

QERSHOR, 2026

REZYME

TRASHËGIMIA KULTURORE DHE HISTORIKE E ANAMORAVËS-KONCEPTET E MBROJTJES DHE MENAXHIMIT

Mentori: Prof. Ass. Dr. Nuri Bexheti

Kandidati: Alban Sahiti

Ky punim trajton Trashëgiminë Kulturore dhe historike te Regjionit te Anamoravës në veçanti të komunave si Gjilani, Vitia, Kamenicës dhe Artanës.

Punimi ka për qëllim hulumtimin, mbi të kaluarën duke analizuar trashëgiminë ndër vite e cila ka lënë gjurmë qysh nga kohët e hershme ku shpesh i hasim edhe si dëshmi mbi të kaluarën historike ku vazhdon të promovohet, duke përfshirë zakonet, traditat, monumentet, artefaktet, gjetjet etj.

Regjioni i Anamoravës përfshinë një gamë të gjerë mbi gjetjet dhe zbulimet që janë bërë ndër shekuj duke dëshmuar rëndësinë e saj mbi trashëgiminë në përgjithësi në Kosovë.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë të kaluarën por mbi të gjitha rëndësinë e ruajtjes dhe menaxhimit në mënyrë që të mos humbet dhe të bartet me dëshmi te dokumentuara për brezat e rinjë, duke krijuar forma të hulumtimit, zhvillimit dhe studimit. Sfidat praktike dhe potencialet për përmirësim duke kontribuar ne zhvillimin e një modeli të integruar dhe të qëndrueshëm menaxhimi.

Objektivat e hulumtimit janë:

- Analizimi i të kaluarës dhe të tashmes mbi trashëgiminë
- Analizimi i mbrojtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë
- Hulumtimi dhe analizimi i politikave
- Shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe institucional

- Konceptet dhe metodat për promovimin e trashëgimisë së Kosovës

Pyetjet e hulumtimit

1. Si ndikuan politikat për trashëgiminë e Kosovës përkatësisht të regjionit të Anamoravës?
2. A është punuar mjaftueshëm nga institucionet për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë?
3. Cilat janë hapat që duhet të ndërmerren për të ndikuar pozitivisht mbi trashëgiminë?
4. Sa do të ishte e nevojshme që në shkolla fillore të jetë një lëndë për trashëgiminë kulturore dhe historike të Kosovës?

Rezultatet e hulumtimit

Rezultatet e hulumtimit na tregojnë për rëndësinë e ruajtjes, konservimit e menaxhimit të të dhënave të cilat i posedojmë nga e kaluara. Gjithashtu analiza e ndikimeve demografike, shoqërore dhe kulturore në regjionin e Anamoravës na tregojnë faktin se ka një përbërje me rëndësi të madhe për vendin tonë e cila duhet të ruhet me shumë kujdes.

E fundit por jo nga rëndësia është edhe rezultati në bazë të hulumtimit për nevojën për të pasur një lëndë të veçantë në shkollat fillore e cila do të jetë edhe me vizita në vendet ku gjenden monumentet kryesore të Kosovës.

Përfundimet

Trashëgimia kulturore dhe historike e Anamoravës si dhe e Kosovës në përgjithësi është një pjesë shumë e rëndësishme pasi na mundëson që të dijmë për paraardhësit tanë, të kaluarën e vlefshme e cila duhet të ruhet me shumë fanatizëm.

Nevoja mbi menaxhimin, ruajtjen dhe mbrojtjen nëpërmjet komunitetit por më e rëndësishme edhe nëpërmjet ligjit dhe institucioneve, rëndësia e politikave të cilat zhvillohen në vend në mënyrë që mos të humbet trashëgimia për brezat e rinjë.

Fjalët kyqe:

Anamorava, trashëgimia, ndikimet politike, vlerat, historia etj.

